REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr._____Prot. Tiranë, më 04.11.2026

MBLEDHJA Nr. 48,
Datë 06.11.2026, ora 13:00
e Bordit të ERE-s.

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 59/2026, "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*"; (ii) nenit 9, të "*Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë* (ERE)", miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të "*Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s"*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 06.11.2026, ora 13:00,** do të zhvillohet mbledhja nr. 48 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin tetor 2026 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Mbi vijimin e procedurës së filluar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 345, datë 29.12.2025, "Mbi kërkesën e shoqërisë "VOLTON" sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë OSSH sh.a., lidhur me pikën e matjes "TONA ALB/6390".

3. Mbi kërkesën e shoqërisë "KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (sh.a. KESH)" sh.a. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-et Lundruese "Tigri 1", me kapacitet të instaluar 50 MW dhe "Tigri 3", me kapacitet të instaluar 60 MW.

4. Mbi kërkesën e shoqërisë "EZ-5 ENERGY" sh.p.k. për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike në kuadër të licencës së prodhimit të energjisë elektrike për centralin fotovoltaik 10 MW.

5. Mbi kërkesën e shoqërisë "EZ-5 ENERGY" sh.p.k. për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike në kuadër të licencës së prodhimit të energjisë elektrike për centralin fotovoltaik 30 MW.

6. Mbi kërkesën e shoqërisë "KRONOS KONSTRUKSION" sh.p.k. për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike në kuadër të licencës së prodhimit të energjisë elektrike për centralin fotovoltaik 50 MW.

7. Mbi fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, rinovimin, njohjen dhe transferimin e licencave në sektorin e energjisë elektrike".

8. Mbi fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores "Për procedurat e thjeshtuara të licencimit në sektorin e energjisë elektrike".

9. Mbi fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin dhe miratimin e modelit tip të Licencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike.

10. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit".

11. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e "Rregullores për përcaktimin e kritereve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit.

12. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e "Metodologjisë teknike dhe financiare të ndarjes së energjisë elektrike dhe të përfitimeve financiare brenda Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme, format dhe mënyrat e ndërveprimit me operatorët e rrjetit, dhe tarifat e regjimit të rrjetit, si dhe kufizimet përkatëse".

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI

Petrit AHMETI